



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL SEKTORI ONE STOP SHOP

Informacion ne lidhje me Organizimin dhe funksionimin e Bashkise.

KERKESA , ANKESA , SINJALIZIME DHE VEREJTJE QE LIDHEN ME VEPRIMET OSE MOSVEPRIMET E ORGANEVE DHE ADMINISTRATES

- a) Procedura per te bere kerkese , ankese dhe sinjalizime oraganeve te bashkise.**

One stop shop funksionon si pjesë e strukturës organizative të Bashkise, nepermjet te ciles cdo person fizik apo juridik i cili kerkon nje sherbim, paraqet nje kerkese per marrje sherbimi, ankese, aplikim, kerkese per informacion ose paraqet nje propozim duke komunikuar ne menyre zyrtare me depozitim te shkreses ne zyren e sherbimit me nje ndalese/ONE STOP SHOP , nepermjet postes, email-it, fax-it dhe SMS-ve

- b) Rregullorja e brendshme per procedure e shqyrtimit ,te hetimit administrativ,te sinjalizimit dhe mekanizmat e mbrojtjes se konfidencialitetit.**

1. Pikat e shërbimit me një ndalesë janë përgjegjëse për:

- a) këshillimin e të interesuarve në të njëjtën mënyrë si organi publik kompetent;

- b) pranimin e kërkesave për nxjerrjen e një akti administrativ apo kryerjen e një veprimi tjetër administrativ, si dhe paraqitjen e mendimeve, shpjegimeve, propozimeve, komenteve, dokumenteve apo mjeteve ligjore administrative ;
- c) njoftimin e kërkuarit për çdo akt dhe veprim procedural të organit publik kompetent, si dhe për çdo komunikim ndërmjet palës së interesuar dhe organit publik kompetent, në lidhje me aktivitetin specifik.

2. Pikat e shërbimit me një ndalesë informojnë apo vënë në dispozicion të të interesuarve, të gjithë informacionin e nevojshëm për procedurën administrative. Informacioni përfshin edhe të dhëna për mjetet dhe kushtet për aksesin në dokumentacionin arkivor të bashkise , si dhe për mjetet e ankimit, në rast mosmarrëveshjeje

LIGJI 119/2014

1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike.
2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë.
3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.

E DREJTA E INFORMIMIT DHE TRANSPARENCA

1. Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet.
2. Autoriteti publik është i detyruar të informojë kërkuarin nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar.
3. Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit. 4. Informacioni publik që i është dhënë një

personi, nuk mund t'i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji.

d. Adresa Postare/elektronike per depozitimin e kerkesave ankesave,sinjalizimeve apo verejtjeve.

Ne menyre zyrtare me depozitim te shkreses ne zyren e sherbimit me nje ndalese/ONE STOP SHOP , nepermjet postes, email-it, fax-it dhe SMS-ve.

e. Afati dhe menyra e kthimit te pergjigjeve ne lidhje me kerkesat ,ankesat apo verejtjet.

Neni 137

3. Afatet për Bashkinë Devoll fillojnë të llogariten me depozitimin e kërkesës dhe të dokumentacionit të plotë në pikën e shërbimit me një ndalesë, apo sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative .



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DEVOLL
ZYRA ONE STOP SHOP**

Nr. _____ i kërkesës

Bilisht më, ____/____/2021

Lenda :Kërkesë për marrje shërbimi

Drejtuar: _____

Në bazë të rregullores për "ORGANIZIMIN,FUNKSIONIMIN,DETYRAT DHE KOMPETENCAT E ADMINISTRATËS SË BASHKISË DEVOLL" neni 14 pika 3 e cila bën fjalë mbi bashkëpunimin ndërmjet strukturave të administratës së bashkisë ndërmjet sektorëve përkatës si dhe pikes 4 të po këtij neni e cila ju vendos para përgjegjesisë për të dhënë një përgjigje brenda një afati 5 ditor të përcaktuar në këtë rregullore ju kërkojmë zyrtarisht marrjen në shqyrtim të një kërkesë ankese të mbëritur pranë zyrës One Stop Shop në Bashkinë e Devoll.

Sa mëposhtë ju informojme se:

Bashkangjitur ju vemë në dispozicion kërkesë ankesën të kryer pranë zyrës One Stop Shop të Bashkisë Devoll me numër _____, datë ____/____/2021 e paraqitur me shkrim nga shtetasi z. _____ banues ne _____

Për vazhdimin e mëtejshëm të procedurës mbi dhënien e shërbimit të kërkuar nga ky qytetar është e nevojshme që brenda afateve që ligji Mbi te Drejtat e Informimit të Qytetarëve si dhe Regullorja e Bashkisë për "Organizimin,Funksionimin,Detyrat dhe Kompetencat e Administratës së Bashkisë Devoll" të na vendosni në dispozicion pranë zyrës One Stop Shop përgjigjen tuaj zyrtare në lidhje me këtë kërkesë ankesë brenda datës ____/____/2021

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

(Personi përgjegjës që morri dorrëzim)

Përgjegjësi I Sektorit

Përgjegjëse e One Stop Shop:

Elona Berberi

